




Republika e Kosovës
Republic of Kosovo
Republika Kosova



Komuna Skenderaj
Municipality of Skenderaj
Opštine Skenderaj

Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë

Directorate for Geodesy, Cadastre and Property

Direkcija za Geodeziju Kadastar i Imovinu

Raporti vjetor i punës për vitin 2025

Hyrje

Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, në përputhje me mandatin e saj ligjor ka arritur të realizoj shumicën e objektivave të parapara për vitin 2025.

Që nga fillimi i periudhës Janar 2025, prioritet kryesor kanë qenë kërkesat dhe lëndët e papërfunduara të vitit paraprak dhe shqyrtimi i të gjitha kërkesave brenda afatit ligjor të rregullt.

Prioritet tjetër ka qenë gjithashtu edhe thellimi i bashkëpunimit me të gjithë sektorët në Komunën e Skënderajt si dhe me organet e tjera relevante në nivel Qendror të Republikës së Kosovës.

Janë bërë shumë reforma në infrastrukturën ligjore me anë të udhëzimeve administrative nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës si dhe nga Agjencia Kadastrale e Kosovës, të cilat kanë dhënë rezultat pozitiv në rritjen e efikasitetit të punës në Sektorin e Gjeodezisë dhe Kadastrit.

Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në përbërje ka gjithsej tre sektorë të cilët dallojnë për nga lloji i shërbimeve që i ofrojnë dhe për nga lloji i lëndëve që është në kompetencë të tyre për ti shqyrtuar, mirëpo që në praktikë ndërlidhen ngushtë me njëra-tjetrën.

Brenda Drejtorisë së GJ.K.P-së pranohen dhe shqyrtohen kërkesat dhe lëndët si në vazhdim: kërkesat për ndërrim të pronarit (shitblerje, këmbim, trashëgimi, etj), kërkesat për regjistrimin, modifikimin dhe fshirjen e hipotekave, kërkesat për modifikimin, ndarjen dhe bashkimin e parcelave, kërkesat për regjistrimin e ndërtesave dhe pjesëve të ndërtesave si dhe modifikim, bashkimin dhe ndarjen e ndërtesave dhe pjesëve të ndërtesave, kërkesat për pajisjen me certifikata të paluajtshmërive dhe kopje të planit, kërkesat për këmbim të pronave të paluajtshme që janë në posedim të Komunës (Komunë – Person Fizik apo Juridik), kërkesat për dhënien në shfrytëzim me kohë të caktuar të paluajtshmërive që janë në posedim apo pronësi të Komunës, kërkesat për modifikimin e të dhënave të personit në Regjistrin e të Dhënave të Pronave të Paluajtshme (RDPP), kërkesat për historiate të parcelave, kërkesa të tjera që dalin nga sektorët brenda administratës komunale, etj.

Përshkrimi i punëve dhe aktiviteteve

Gjatë kësaj periudhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë ka zhvilluar aktivitete dhe detyra që dalin nga kompetencat që ka.

Në kuadër të këtyre detyrave dhe obligimeve ka kryer këto aktivitete: takime zyrtare me institucionet përkatëse siç është Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministria e Financave, Agjencia Kadastrale e Kosovës, Agjencia Kosovare e Privatizimit si dhe institucione të tjera. Pjesë e punës ishin gjithashtu aktivitetet në teren brenda territorit të Komunës së Skënderajt, duke qenë kështu çdoherë pranë dhe në shërbim të qytetarëve si dhe aktivitete të tjera *ex officio* që kanë qenë nevojë e Komunës.

Gjithashtu janë kryer të gjitha shërbimet që kanë qenë kërkesë e qytetarëve në zyrat tona siç janë pajisja me certifikata të pronësisë, kopje të planit dhe shërbimet e tjera të cilat i kemi përshkruar në hyrje të këtij raporti vjetor të punës.

D-Gj.K.P do të vazhdojë me aktivitetet e saj pa ndërprerë në kuadër të detyrave, që të jemi sa më efikas krahas kërkesave dhe shërbimeve ndaj qytetarëve të Komunës sonë, si dhe ndaj institucioneve tjera në Republikën e Kosovës.

Në kuadër të përgjegjësi D-Gj.K.P në përgjithësi, e stafi i drejtorisë në veçanti, kanë qenë në nivel të detyrës, kështu duke shqyrtuar kërkesat e pastaj duke aprovuar apo refuzuar ato varësisht nga lloji i tyre, si dhe duke pritur në takim çdo pale për ti ofruar sqarime të nevojshme juridike-pronësore, duke u munduar për gjetje të zgjidhjeve ligjore rreth problemeve pronësore.

Duhet përmendur fakti se drejtoria jonë i është përgjigjur çdoherë pozitivisht të gjitha kërkesave nga Drejtoria e Inspektoriatit për të cilat ka ekzistuar dyshimi për uzurpim duke bërë kështu vërtetimin dhe identifikimin e gjendjes faktike si dhe kërkesave nga Drejtoria e Urbanizmit dhe drejtorive tjera duke bërë identifikimin dhe matjet gjeodezike për realizimin e projekteve komunale.

Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë ka zbatuar thuajse në plotni rekomandimet e nxjerrura nga raportet e monitorimit nga Agjencia Kadastrale e Kosovës, në sektorin e Gjeodezisë dhe Kadastrit.

Gjatë vitit 2025 Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë ka shfrytëzuar të gjithë potencialin dhe kapacitetin e saj edhe përkundër numrit të vogël të punëtorëve, me qëllim për rritjen e performancës, përgjegjësisë në punë, bashkëpunimit dhe koordinimit më të mirë në mënyrë që qytetarëve të Komunës së Skënderajt të i'u ofrohen shërbime sa më të mira pronësore-kadastrale.

Lista e kërkesave për 2025

Siç e kemi cekur edhe më lartë në fillimin e vitit 2025, prioritet kryesor ka qenë shqyrtimi i të gjitha kërkesave dhe lëndëve të papërfunduara të vitit paraprak.

Bashkangjitur keni të dhënat për lëndët dhe kërkesat e realizuara nga Sektori për Gjeodezi dhe Kadastër, për periudhën Janar 2025 – Dhjetor 2025.

Kërkesat	Të pranuara	Të miratuara	Të refuzuara	Në proces	Gjithësej
Certifikata të Paluajtshmërisë	2856	2856	0	0	2856
Kopje të Planit	961	960	1	0	961
Bartje e Pronësisë apo Posedimit	1032	1024	8	0	1032
Modifikim i parcelave	124	120	4	0	124
Bashkim i parcelave	63	62	1	0	63
Ndarje e Parcelave	142	134	8	0	142
Regjistrim i ndërtesave	30	29	1	0	30
Regjistrim i pjesëve të ndërtesave	29	29	0	0	29
Regjistrim, Barje e qiramarrjes	38	35	3	0	38
Regjistrim i ngarkesës tatimore	4	4	0	0	4
Fshirje e ngarkesës tatimore sipas vendimit të ATK-së	3	3	0	0	3
Bashkim i personave të njejtë me ID të ndryshme në RDPP	15	15	0	0	15
Regjistrim, Modifikim dhe Fshirje e Hipotekave	77	75	2	0	77
Modifikim i të dhënave të personave në RDPP	56	55	1	0	56
Vërtetim që nuk posedon pronë	31	31	0	0	31
Kërkesa për shfrytëzim të pronës komunale (parkingje)	33	13	0	20	33
Kërkesa për heqje dorë nga pronësia	1	1	0	0	1
Të tjera					
TOTAL					5495

Raporti financiar i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë
Janar 2025 - Dhjetor 2025

Sektori për Gjeodezi dhe Kadastër

UNIREF	Dokumenti	Shuma
SKG4L	Regjistrim, Modifikim, Bartje e Pronësisë apo Posedimit	35,798 €
SKG4M	Taksë - Ndërrim i destinimit të tokës	1435 €
SKGFP	Taksë për fletë poseduese dhe kopje të planit	9257 €
SKG4U	Taksë administrative	4295 €
SKG9D	Aktivitete në teren	26,338 €
Totali i të hyrave në këtë sektor:		77,123 €

Sektorit i Pronës

UNIREF	Dokumenti	Shuma
SKG8E	Rente - Shfrytëzimi i pronës publike	11,819.05 €
SKG8H	Qiraja nga objektet publike	17,099.36 €
Totali i të hyrave në këtë sektor:		28,918.41 €

Totali të hyrave në Drejtorinë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë për periudhën
Janar 2025 – Dhjetor 2025 është: **106,041.41 EURO**

Në përmbyllje, gjatë periudhës raportuese janë realizuar detyrat dhe përgjegjësitë në përputhje me kompetencat e përcaktuara dhe planin e punës të vitit 2025.

Aktivitetet e ndërmarra janë zhvilluar në përputhje me procedurat ligjore dhe administrative, duke realizuar kështu objektivat e parapara!

Skënderaj, 08.01.2026



Kreshnik Smakiqi
(Drejtorja për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë)